




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**



**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**

Datë: 08.08.2023  
Ref. KM-272/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

:

**VENDIM**

**Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim**

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – Boom Efekt i prodhuesit “Albaugh TKI “d.o.o, Slloveni, nga përfaqësuesi i saj “Agronomi Group shpk”Suhareke.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Herbicid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Glyphosate.....360g/L.

**4. PËRDORIMI:**

Preparati mund të përdoret si herbicid joselektiv sistemor për asgjësimin e krisjeve **njëvjeçare dhe shumëvjeçare në:**

1. stërnishta, pemishte, vreshta dhe në sipërfaqe jobujqësore për zhdukjen e:

a) krisjes njëvjeçare në raport 2-3 L/ha (20-30 ml në 100 m<sup>2</sup>);

b) krisjes shumëvjeçare varësisht nga lloji i raportit:

-8-9 L/ha (80-90 ml në 100 m<sup>2</sup>) për zhdukjen e *Cynodon dactylon*, kur krisja arrin lartësinë 15-20 cm;

- 6-8 L/ha (60-80 ml në 100 m<sup>2</sup>) për zhdukjen e *Convolvulus arvensis* në kohën e lulëzimit;

- 6-7 L/ha (60-70 ml në 100 m<sup>2</sup>) për zhdukjen e **ferrëmanzave (*Rubus spp.*)** në shtator dhe tetor;
- 4+1 L/ha në aplikimin e ndarë (split) (40 + 10 ml në 100 m<sup>2</sup>) për zhdukjen e ***Cyperus rotundus*** në kohën e lulëzimit;
- 3,5-5 L/ha (35-50 ml në 100 m<sup>2</sup> për zhdukjen e melekuqes së egër (***Sorghum halepense***) në fazën e bulëzimit, ***Cirsium arvense***, **ufullaçkës gjethrrudhur (*Rumex crispus*)** ufullaçkes gjethtopitur (***Rumex obtusifolius***) dhe mendrës së thjeshtë (***Artemisia vulgaris***), kur krisja arrin 40 cm, lule dyllin (***Taraxacum officinalis***),
- 2,5-3,5 L/ha (25-35 ml në 100 m<sup>2</sup>) për zhdukjen e ***Elymus repens*** kur arrin lartësinë 25-30 cm. Raportet e shënuara i përdorim me sasi të ujit 100-200 L në ha (1-2 L ujë në 100 m<sup>2</sup>).

## 2. Pyje:

a) Në fidanishtet pyjore të dëllinjës dhe pishës së kuqe për zhdukjen e krisjes fletëgjërë dhe fletëngushtë:

- në kohën e pushimit të bimëve në koncentrat 1 % me përdorimin e 400 L ujë në hektar (40 ml në 4 L ujë në 100 m<sup>2</sup>) duke e bërë tretmanin e tërë sipërfaqes, apo
- në kohën e rritjes aktive në koncentrat 2 % me përdorimin e 400 L ujë në hektar (40 ml në 4 L ujë në 100 m<sup>2</sup>) duke e bërë tretmanin ndërmjet rreshtave të bimëve duke e përdorur gjithsesi mbrojtësin.

b) Në fidanishtet e rinj të halorëve për zhdukjen e krisjes gjethore së drunjëzuar në koncentrat 1,5 % (75 ml në 5 L ujë në 100 m<sup>2</sup>) me përdorur 300 L ujë për hektar, ashtu që e bëjmë tretmanin ndërmjet rreshtave të bimëve duke e përdorur gjithsesi mbrojtësin.

c) për zhdukjen e të dalave të rrënjëve nga trungjet e gjethorëve (lisit, shkozës dhe qarrit) në koncentrat 15 % (1,5 L në 10 L ujë), me lyerje fill pas prerjes, prej majit deri në dhjetor.

## 5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

0.2L,1L,5L,25L

## 6. VËREJTJE:

Preparati Boom efekt nuk guxon të përdoret në pemishte më të reja se dy vjet dhe as në vreshta më të reja se katër vjet. Gjatë tretmanit në pemishte dhe në vreshta (kur e përdorim mbrojtësin), duhet të mos ia mundësojnë preparatit që të vijë në kontakt me pjesët e gjelbra të bimëve. Për këtë shkak tretmani duhet të bëhet me presion të ulët, që nuk guxon të jetë më i madh se 2 bar, kurse gjatë përdorimit të poliet spërkatëseve jo më i madh se 1 bar.

Për zhdukjen totale të rrënjëve të thella dhe rizomave, truallin, të cilit dëshirojmë t'i bëjmë tretmanin, nuk guxojmë ta punojmë më së paku 60 ditë përpara dhe 28 ditë pas tretmanit. Në truallin e trajtuar nuk guxojmë t'i kullosim kafshët. Bimët e thara nga trualli i trajtuar nuk guxojmë t'i përdorim për ushqimin e kafshëve për shkak të kontaminimit të mundshëm të qumështit.

Preparatin mund ta përdorim vetëm një herë në një sezon.

## 7. KARENCA:

Nuk aplikohet.



## 8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:

GHS09- paralajmërim (cat 1)-i rrezikshëm

**9. VENDI I SHITJËS:** Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

**10.** Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

**11.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



**Faton Peci**

**Ministër**

*Vendimi i dërgohet:*

- *Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;*
- *Shërbimi kufitar fitosanitar;*
- *Inspektorët fitosanitar AUV;*
- *Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Arkivit.*